



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR SEMAN

VENDIM

Nr.4, datë 13.03.2026

PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR
PËR QËLLIME INDUSTRIALE, TË SUBJEKTIT “EL-PETROL” SH.A,
ME VENDNDODHJE: ISH UZINA E PLASTMASIT,
BASHKIA LUSHNJE.**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Seman,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime industriale, të subjektit “EL-PETROL” sh.a, me vendndodhje: Ish Uzina e Plastmasit, Bashkia Lushnje.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor (**pus-shpimi**):

- X= 475487.582
- Y= 4532537.473
- Z= 23 m



- Sasia e ujit që jepet në përdorim : $Q = 2.0 \text{ l/sek}$
- Qëllimi i përdorimit të ujit: Rafineria e naftës, për ftohje.
- Thellësia e pus-shpimit: 100 m
- Thellësia e vendosjes së pompës : 60 m
- Koordinatat e pikës së shkarkimit:

$X = 475433.15;$

$Y = 4532548.62;$

$Z = 22 \text{ m}$

- Prurja që shkarkohet: $Q = 0.09 \text{ l/sek}$

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBL SEMAN

ANDUEL XHINDI

